



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY

Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot No. **03-03/1441/18**
 Dep. **DPK**
 Broj. stranica / Nr. pages **03**
 Datum / Date **16.05.2018**
 PRISHTINE

DATË/A:	14.05.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-1242/18
PËR/ZA/TO:	z. Haxhi BEJTA Menaxher i zyrës së Prokurimit Komuna e Skenderaj
CC:	z. Bekim Jashari Kryetar i Komunës së Skenderajt
NGA/OD/FROM:	z. Shaip HAVOLLI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin me titull: “Hartimi i projekteve ne Komunën Skenderaj” me nr. të prokurimit 643/18/2514/211, nr. të brendshëm 643/18/014/211.

I nderuari z. Bejta,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: **“Hartimi i projekteve ne Komunën Skenderaj”** me nr. të prokurimit 643/18/2514/211, nr. të brendshëm 643/18/014/211, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull: **“Hartimi i projekteve ne Komunën Skenderaj”** me nr. të prokurimit 643/18/2514/211, nr. të brendshëm 643/18/014/211, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik

nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit, me datë 26 prill 2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: AKK-03-03-1242/18, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Hartimi i projekteve ne Komunën Skenderaj**” me nr. të prokurimit 643/18/2514/211, nr. të brendshëm 643/18/014/211, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Skenderaj.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma E-Prokurimi, ka analizuar njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë të hapur, kontratë publike kornizë 36 muaj, llojit shërbime, me vlerë të madhe të parashikuar 350,000.00€. Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka vërejtur që njoftimin për kontratë në nenin III.2.4) Kapaciteti teknike dhe profesionale është kërkuar: “*Operatori ekonomik ofertues duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses min. 3 kontrata ne vlerë min. prej 500,000.00€, të bashkangjitura ne referenca të cilat dëshmoj nëse ka kryer punë në projektim të objekteve, rrugëve, veprave strukturore, kanalizimeve fekale dhe atmosferike si dhe ujësjellësve për tri vitet e shkuara nga publikim i njoftimit për kontratë*”, kërkesë kjo për të cilën Agjencia konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht me nenin 69.

Sipas Legjislacioni në fuqi për Prokurim Publik më saktësisht në nenin 69 paragrafi 4.2. parashihet se “Për të vërtetuar aftësitë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik, autoriteti kontraktues mundet të kërkojë listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkë nënshkrura nga autoriteti i tillë publik; (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi.

Agjencia kundër Korrupsionit, konsideron se këtë rast do të duhej të kërkohej lista e kontratave të bashkangjitura me referenca për përfundimin e kontratave në vlerë totale për të gjitha shërbimet e ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë, e jo si në rastin konkret ku janë kërkuara minimum 3 (tri) kontrata vlerë minimum prej 500,000.00€ (Pesëqind mijë euro).

Konsiderojmë se veprimet e tilla si në rastin konkret e kufizojnë konkurrencë e lirë dhe diskriminojnë operatorët ekonomik të cilët mund të ofrojnë shërbime të tilla të kënaqshme.

Agjenci kundër Korrupsion, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo-diskriminimi, nenin 27 Dosja e tenderit si dhe nenin 69 Aftësitë teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 26.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkeljet e tilla nuk duhet lejuar ne aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsion rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se për këto të gjetura do të njoftohet edhe KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !